



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite  
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA  
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## THIRRJE PËR APLIKIM PROGRAMI PËR SUBVENCIONIMIN E PAGËS dhe PROGRAMI PËR TRAJNIM NË PUNË për personat e riatdhesuar

Me qëllim të ofrimit të mbështetjes për personat e riatdhesuar në Kosovë, për përfitim të njohurive për punë si dhe punësim afatgjatë, në mbështetje të ndërmarrjeve/punëdhënësve të sektorit privat, si dhe në përpjekje të shtuar për të ndihmuar rimëkëmbjen ekonomike gjatë përballjes me pandeminë COVID-19: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) - Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), me mbështetjen e Departamentit për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar (DRPR) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), shpallë thirrjen e hapur për aplikim për mbështetje nga programi për Subvencionimin e Pagës (SP) dhe programi për Trajnim në Punë (TNP), për ndërmarrjet (punëdhënësit) e interesuar nga sektori privat dhe për personat e riatdhesuar në Kosovë, të regjistruar si punëkërkues në ZP.

### **MBËSHTETJA QË OFRON PROGRAMI:**

#### **SUBVENCIONIMI I PAGËS (SP)**

Punëdhënësi do të përfitojë një subvencion prej **50%** të pagës së punonjësit, me të cilin rast shuma e këtij subvencioni nuk mund të jetë më e lartë se **170.00** euro në muaj.

Kohëzgjatja e subvencionit për të gjithë punëkërkuesit e riatdhesuar, të papunë të regjistruar në Zyret e Punësimit (ZP), është 12 muaj, brenda marrëveshjes së nënshkruar 12 mujore.

#### **Kush mund të përfitojë nga Programi për Subvencionimin e Pagës?**

-Ndërmarrjet private  
-Personat e riatdhesuar në Kosovë të regjistruar si punëkërkues në ZP-të, me prioritet të veçantë të papunët afatgjatë;

#### **TRAJNIM NË PUNË (TNP)**

Programi për TNP mbulon koston e aftësimin të punëkërkuesve. Kompensimi në shumën **170.00 euro** në muaj i bëhet drejtpërdrejt të trajnuarit gjatë trajnimit tre mujor.

Ndërmarrjet inkurajohen që ta punësojnë punëkërkuesin pas përfundimit të trajnimit.

#### **Kush mund të përfitojë nga programi për Trajnim në Punë?**

-Ndërmarrjet private;  
-Personat e riatdhesuar në Kosovë të regjistruar si punëkërkues në ZP-të, që nuk kanë përvojë të mëparshme të punës;

## Metoda e aplikimit për NDËRMARRJET PRIVATE

Të gjitha ndërmarrjet private (punëdhënësit) e regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe që janë taksapaguese aktive në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), mund realizojnë të drejtën e aplikimit:

- Regjistrohuni në ZP në Komunën e tuaj;
- Dorëzoni formularin e aplikimit të plotësuar në ZP në Komunën tuaj.
- Formulari i aplikimit dhe të gjitha informatat relevante janë të disponueshme në internet në adresat elektronike: <https://aprk.rks-gov.net/> ose <https://mpms.rks-gov.net/> si dhe të printuara në secilën ZP në tërë Kosovën;
- Aplikantët duhet bashkangjitur në aplikacion çertifikatat e tyre për regjistrimin e biznesit. Ndërmarrjet do të kontaktohen nga ZP me një listë të kandidatëve potencial;

## Metoda e aplikimit për PERSONAT E RIATDHESUAR

- Të gjithë personat e riatdhesuar në Kosovë, të interesuar për të aplikuar duhet të jenë të regjistruar si punëkërkues në ZP-të në Komunën e tyre.

## Afati i aplikimit për programet: (06 - 20 gusht 2020)

Për më shumë informata, luteni që të vizitoni adresat elektronike: <https://aprk.rks-gov.net/> apo <https://mpms.rks-gov.net/>, ose Zyrat e Punësimit në komunën tuaj.

Në rast se keni pyetje në lidhje me programin Subvencionimi i Pagës apo Trajnimit në Punë, ju lutem kontaktoni projektin ALMP2/UNDP në adresën elektronike: [almp.ks@undp.org](mailto:almp.ks@undp.org)

### COVID-19

KUJDES I VEÇANTË gjatë procesit të aplikimit:

- Bartja e maskave, mbajtja e distancës dhe larja e duarve sipas udhëzimeve të IKSHPS-së dhe OBSH-së;
- Në çdo zyre do të mbahet distanca në të gjitha hapësirat prej 2 metrave;
- Asnjë aplikues nuk lejohet të hyjnë brenda institucioneve pa maskë;